



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.333/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesuese, Gyltene Sylejmani dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjor Edona Grajçevci, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicioni AAK-PSD, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, Anr.333/2019 e datës 06.10.2019, me të cilin ka kërkuar që koalicionit AAK/PSD, t'i shqiptohet dënim me gjobë për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore-postimit të fotos në rrjetin social Facebook.

A r s y e t i m

Paraqitësi i ankesës Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me datën 06.10.2019, ka paraqitur ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, koalicioni AAK/PSD, ka vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në rrjetin social facebook, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerja e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të miratohet e bazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës vërtetohet fakti se nga fotografia e postuar në llogarinë e kandidatit për kryeministër Ramush Haradinaj, nga radhët e subjektit politik AAK/PSD, në rrjetin social facebook, përmes të cilës është bërë fushatë zgjedhore.

Prova e vetme e dorëzuar nga ankuesi është një fotografi e postuar në llogarinë e kandidatit në rrjetin social facebook, nuk ka datë të postimit (kur është postuar), pra nuk mund

të identifikohet pretendimi i parashtruesit të ankesës se nga ana e subjektit politik AAK/PSD, është thyer heshtja zgjedhore përmes veprimit/ sponzorizimit të fushatës zgjedhore me anë të postimit të fotografisë në llogarinë e kandidatit të lartëcekur, në rrjetin social facebook, në mungesë të argumentimit të datës së postimit.

Paneli vlerëson se në bazë të fotografisë të prezentuar si provë materiale, e cila gjendet në shkresat e lëndës, nuk mund të konstatohet qartë dhe bindshëm siç përcaktohet me nenin 117 parag.3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar ka shkelur Kodin e Mirësjelljes, përmes thyerjes së heshtjes zgjedhore me datë: 05.10.2019, përmes të bërit fushatë në çfarëdo mënyre.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e konform nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.333/2019 më datën 07.10.2019

Kryesuese i Panelit
Gyltene Sytejmani



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*